

**PROGRAMI I PRAKTIKËS PROFESIONALE PËR CIKIN E DYTË TË STUDIMEVE
(Master Profesional)**

Të nderuar studentë!

Ju do të kryeni praktikën profesionale e cila do të zgjasë _____ në përputhje me programin e studimeve të miratuar.

Ju duhet të **gjeni individualisht vendet e kryerjes së praktikës profesionale** të cilat mund të jenë: Ndërmarrje Agrobiznesi (inpute, prodhimi dhe outpute), Ferma të mëdha (serra, komplekse blegtorale, plantacione vreshtash ose drufrutorësh etj), Banka te nivelit të dytë, organe në sistemin Tatim-Taksa, Sistemi Doganor, organe të qeverisjes qendrore dhe lokale (Bashki, Komuna), etj.

Mbeshtetur ne programet e lendeve qe ju keni zhvilluar si dhe në vartësi të vëndit ku do të kryhet ajo, Ju duhet të sillni **një raport** me shkrim të strukturur në dy pjese.

Pjesa e parë duhet të përmbajë sa më poshtë:

1. Formën e organizimit të ndërmarrjes ku ju kryeni praktiken profesionale (*SH.P.K, Shoqëri Anonime, etj*)
2. Formën e organizimit të brendshëm dhe mënyrën e funksionimit të saj, statutin e shoqërisë, veçanërisht me ato "filial dhe mëmë" që kanë lidhje me kapitalin e themelimit, menyrën e organizimit dhe të funksionimit, kriteret e llogaritjes dhe shpërndarjes së fitim/humbjeve, krijimi i rezervave dhe fondeve të ndryshme.
3. Strukturën organizative të firmes (organogramen), vendin që zëne Departamentet e ndryshme në të, nivelin e integritimit vertikal, etj.
4. Një përshkrim të shkurtër të **detyrave kryesore të realizuara nga ju** në Ndërmarrje si dhe dokumentacionin më kryesor të njohur dhe përdorur nga ju gjatë kohës së kryerjes së praktikës.

Pjesa e dytë duhet të trajtojë problematikën e mëposhtme (Varësisht profilit të subjektit ku do të kryhet praktika):

A- Njohuritë kryesore të aftësisit tuaj praktik në lidhje me **Drejtimin dhe Marketingun**, që hasin kryesisht ndërmarrjet e agrobiznesit si:

- Njohja dhe përshkrimi i formës së organizimit të ndërmarrjes, avantazhet dhe dobësitë e saj;
- Analiza e mjedisit të jashtëm e të brendshëm të kompanisë dhe formulimi i strategjive; vlerësimi i strategjive të biznesit; probleme të implementimit të tyre dhe roli i menaxhimit (organizimi; kontrolli, etj) në suksesin e tyre;
- Përshkrimi i ambientit të MKTG dhe drejtimit, analiza SWOT; plani i marketingut dhe i prodhimit;
- Vlerësimi i gjendjes aktuale të MKTG lidhur me 4 aspektet e tij: Produkti, Shpërndarja, Promocioni dhe Çmimet;
- Analizë të funksioneve bazë menaxheriale si edhe rolit të organizatës në rastin e institucioneve publike ose organizatat e pavarura.
- Sfida të zhvillimit strategjik të të gjitha llojeve të ndërmarrjeve në sektorin publik dhe atë privat.

B- Studenti do të njihet dhe do të raportojë për çështjet e **analizës financiare** duke siguruar për çdo dokument apo libër kontabël një kopje të tij, si më poshtë:

1. Vleresimi i gjendjes financiare të kompanisë.
2. Analiza nëpërmjet treguesve të elementëve të kapitalit qarkullues, llogaritja e përdorimit me efektivitetin të këtyre elementëve.
3. Trajtimi i problematikes që ka të bëjë me vendimarrjen financiare

C- Përsa i takon fushës së **Institucioneve Financiare**, studenti do të njihet, do të ndjekë dhe analizojë si më poshtë:

1. Njohja me dokumentacionin dhe operacionet bankare. Këtu përfshihen si dokumentacioni kontabël ashtu edhe dokumentacioni analizues (bilanci kontabël dhe pasqyrat e analizës) si edhe operacionet bazë të njësive bankare.
2. Njohja dhe plotësimi i instrumentave të pagesës. Këtu përfshihen llojet e ndryshme të çeqeve, urdhërkalimi, letrat e kreditit, karta e kreditit dhe e debitit etj.
3. Njohja me operacionet e shërbimit në sportel të bankës. Lëvizjen e parave (Cash-i), dhe shërbimi në sportel.
4. Njohja me praktiken e kreditimit dhe investimit të institucioneve financiare.
5. Analiza e një rasti studimi të praktikave të kredisë të një firme agrobiznesi që është e mundur të bëhet duke analizuar dosjen e një kredimarrësi të kësaj fushe.

DEPARTAMENTI I DREJTIMIT TË AGROBIZNESIT